



**VENDIM**

**Nr. 119 Datë 28.10.2013**

**MBI  
MIRATIM E PLAN PROTOKOLLIT TË PAGESAVE NDAJ PALËVE TË  
TRETA TË CEZ SHPËRNDARJE SH.A NË ADMINISTRIM TË  
PERKOHSHËM PËR MUAJIN NËNTOR 2013**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 14, pika 3 të Rregullores për Procedurat e Emërimit të Administratorit dhe Kompetencat e tij, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 1, datë 10 .01.2013, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë së Çmimeve dhe Tarifave, lidhur me skedulimin e pagesave dhe të plan – shpenzimeve të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (në administrim të përkohshëm),

**Konstatoi se:**

Në kushtet e humbjeve prej 44.5% dhe arkëtimeve 78.3%, situata e kompanisë është shumë e vështirë dhe nuk jemi në kushtet e miratimit të një plan protokollit pagesash zë për zë, përveçse renditje të zërave prioritare pa cenuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Miratimin e renditjes së plan protokollit të pagesave ndaj palëve të treta të CEZ Shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm për muajin Nëntor 2013 si më poshtë:
  - a. Detyrimin mujor për prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes.
  - b. Detyrimin mujor të KESH sh.a.
  - c. Detyrimin mujor të OST sh.a deri në faturën korente.
  - d. Pagesa “Te tjera”.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë shoqërinë CEZ Shpërndarje sh.a (në administrim të përkohshëm), për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-s**

**Petrit AHMETI**